



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 80 date 01/11/2002

**PER
KRIJIMIN E SEKTORIT TE INVENTARIZIMIT TE PRONAVE TE
PALUAJTSHME QE DO T'I TRANSFEROHEN BASHKISE SE TIRANES**

Në mbështetje të neneve 32 gërma “ç” të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të Ligjit Nr.8743 dt.22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit, të Ligjit Nr.8744 dt.22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, V.K.M. Nr.500 dt.14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, pika 9 dhe 10 dhe udhëzimeve përkatëse, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2002” pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Ngritjen e një sektori me karakter të përkohshëm me afat deri në 2 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, me emërtimin “Sektori i Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme të Bashkisë”, në strukturën organizative të Bashkisë Tiranë

2. Sektori i Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme të Bashkisë të përbëhet nga 5 punonjës sipas strukturës bashkëngjitur.
3. Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, numri i punonjësve të përballohen brenda numrit limit të miratuar të punonjësve me kontratë të Bashkisë së Tiranës për vitin 2002
4. Efektet financiare (paga dhe sig. Shoqërore) në zbatim të pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi të përballohen nga fondi i pagave të punonjësve me kontratë miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike për zbatimin e këtij Vendimi
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Leonidha TOSKA

